



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: OMK) në vazhdim të aktivitetëve të saj, duke u bazuar në dispozitat e Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional në lidhje me përkrahjen e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore shkencore të vendit dhe me qëllim të promovimit të shkencës kosovare shpall:

**KONKURS  
(PËR PËRKRAHJE FINANCIARE TË PUNIMEVE SHKENCORE)**

Oda e Mjekëve të Kosovës i bënë thirrje mjekëve kosovar të konkurrojnë për përfitimin e granteve shkencore për punimet e publikuara përgjatë periudhës 2018 dhe 2019. Pesë (5) punimet e përzgjedhura sipas kriterëve të poshtëshënuara do të përfitojnë shumën në vlerë prej 3.000 € (euro).

**Kushtet dhe procedurat**

**Kriteret obligative të pranimit janë:**

- Mjeku duhet të jetë anëtar i Odës së Mjekëve të Kosovës;
- Mjeku duhet të jetë autor i parë i punimit shkencor;
- Periudha kohore e publikimit të punimit duhet të jetë përgjatë vitit 2018 dhe 2019

**Kriteret selektive të pranimit llogariten me sa vijon:**

1. Origjina e punimit:
  - a. Kosovë vlerësohet me **4 pikë**
  - b. Jashtë Kosovës vlerësohet me **2 pikë**
2. Lloji i punimit:
  - a. Research Article, Original Article, Review, Meta-analysis vlerësohen me **8 pikë**
  - b. Case report vlerësohet me **4 pikë**
  - c. Tjera (*correspondence, letter to the editor, short communication*) vlerësohen me **2 pikë**

### 3. Impakt faktori

**Mënyra e vlerësimit:** Totali i pikëve do të llogaritet **përmes shumëzimit** të vlerave numerike të kritereve obligative dhe selektive të lartëpërmendura (\*).

*\*Nëse vlera numerike e kritereve obligative është 0 (zero), atëherë numri total i pikëve do të rezultojë me vlerë zero dhe kandidati do të eliminohet nga konkurrimi.*

#### ***Koment shtesë:***

Nëse në fund të listës së kandidatëve të përzgjedhur rezulton më tepër se një kandidat me pikë të njejta, atëherë shumta e dedikuar ndahet në përpjestim të barabartë me numrin e kandidatëve.

-Një kandidat ka të drejtë aplikimi me vetëm një punim.

Për të aplikuar, të interesuarit duhet të dërgojnë (I). Formularin për aplikim (e gjeni të bashkangjitur) dhe (II). Punimin me të cilin aplikoni. Dokumentet mund të dërgohen përmes email adresës zyrtare të Odës: [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org) duke shënuar në subjekt (subject) që jeni duke ju përgjigjur konkursit publik për përkrahje financiare të punimit shkencor. Të njejtat mund t'i dërgoni në kopje fizike pranë zyreve të OMK-së, QKUK, Insitutet A, Kati III, 10 000, Prishtinë.

Afati për konkurim është i hapur nga data: **01 korrik 2019** deri **15 gusht 2019** në ora 16:00.

*Për sqarime dhe pyetje në lidhje me konkurimin ju lutëm drejtohuni pranë zyrës ligjore të OMK-së: [betime.baftiu@omk-rks.org](mailto:betime.baftiu@omk-rks.org) dhe [rina.halilaj@omk-rks.org](mailto:rina.halilaj@omk-rks.org) apo kontaktoni në numrat e telefonit 049-872-300 dhe 049-872-070.*